



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

**Ref. Nr. 2654/24**

**Pejë, 15.10.2024**

Në bazë të nenin 42, 47, 48, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregullores për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në UHZ nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur më dt. 14.10.2024, pas shqyrtimit të propozimeve të njësive akademike, vendosi që të rishpall:

**KONKURS**

**Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për vitin akademik 2024/25**

Konkursi rishpallet sipas propozimeve të njësive akademike dhe atë si në vijim:

**FAKULTETI I BIZNESIT**

**Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:**

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndën: Matematika I (TIBE, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O).
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Menaxhimi i Dijes me Elemente të Intelegjencës Artificiale (IB, MSc, 3 orë, sem. dimëror, Z), Bazat e Programimit (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z), Komunikimi Mobil në Biznes (TIBE, BSc, 2 orë, sem. pranveror, Z).
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Bazat e IT-së (MB, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Teknologji e Informacionit (TIBE, BSc, 4 orë, sem. dimëror, O), Teknologji të Internetit (TIBE, BSc, 4 orë, sem. pranveror, O), Biznesi Elektronik (TIBE, BSc, 4 orë, sem. pranveror, O).

**ZAHTJEV ZA ANGAŽOVANJE AKADEMSKOG OSOBLJA NA BOSANSKOM JEZIKU ZA AKADEMSKU 2024/2025 GODINU**

1. Jedan predavač za predmete: Korporativne finansije (MB, BSc, 3 časa, zimski semester, O), [Napredno](#) finansijsko upravljanje (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, O).
2. Jedan predavač za predmete: Upravljanje JPP (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, I).
3. Jedan predavač za predmete: Engleski jezik II (MB, BSc, 3+2 časa, zimski semester, I), Engleski jezik I (MB, BSc, 3+2 časa, ljetnji semester, O).
4. Jedan asistent za predmete: Osnovi računovodstva (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Korporativne finansije (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O),

Napredno finansijsko upravljanje (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Mikroekonomska analiza (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Monetarna ekonomija (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, I), Totalno upravljanje kvalitetom (MB, MSc, 2 časa, ljetnji semester, O).

5. Jedan asistent za predmete: Akademsko pisanje (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Kvalitativne metode u naučnom istraživanju (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Biznis okoliša (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Strateški menadžment (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Osnovi menadžmenta (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O), Komunikacija u biznisu (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O), Lideršip (MB, BSc, 2 časa, ljetnji semester, O).
6. Jedan asistent za predmete: Upravljanje projektima (MB, BSc, 2 časa, zimski semester, O), Preduzetništvo i inovacije (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O), Upravljanje projektima EU (MB, MSc, 3 časa, zimski semester, O), Liderstvo i odlučivanje (MB, MSc, 2 časa, zimski semester, O).

## **FAKULTETI JURIDIK**

### **Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:**

1. Një bashkëpunëtor për ligjërata në lëndët: E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane e Mjedisit (LLM) 2 orë; E Drejta Biznesore e Bashkimit Evropian (LLM) 2 orë (semestri dimëror); E Drejta e Pronësisë Intelektuale dhe Teknologjia (LLM) 2 orë; E Drejta Evropiane Administrative 2 orë (semestri veror);

## **FAKULTETI I AGROBIZNESIT**

### **Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Fizikë, TU (Semestri dimëror 2 orë ligjërata + 2 orë ushtime) ( TU );
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Informatikë e Aplikuar në Bujqësi, ( AA, TPB ), Teknologji e Informacionit, ( TU ) (Semestri dimëror 4 orë ligjërata 1 orë ushtime);

## **FAKULTETI I ARTEVE**

### **Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata:**

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Bazat e orkestrimit 1- 2+0, Aranzhim 1-2+0 semestri dimëror 4 orë, Bazat e orkestrimit 2- 2+0, Aranzhim 2-2+0 semestri veror 4 orë;
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata për lëndët: Pedagogji muzikore - Emm 2+0, Pedagogji e mësimit të muzikës -Em 2+0, semestri dimëror 4 orë Pedagogji e mësimit të muzikës -Em -2+0 semestri veror 2 orë;
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për lëndën e korepetimit I, II, III, IV, V, VI;

### **I. Kushtet e përgjithshme dhe procedura për angazhim**

1. Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtime do të behët në pajtim më Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin NR. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022.

2. Procedura e angazhimit bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik sipas kushteve të përcaktuara më Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 1165/22, të dt. 23.05.2022.
3. Bashkëpunëtorët e jashtëm mund të angazhohen në UHZ për një periudhë të caktuar kohore, më qëllim të ofrimit të shërbimeve intelektuale për ligjërata dhe ushtrime mbi bazën e një konkursi publik, për pagesë me honorar. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton themelimin të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
4. UHZ nuk mund të angazhojë në ligjërata përkatësisht ushtrime asnjë bashkëpunëtor të jashtëm, i cili ka më tepër se një angazhim jashtë UHZ - së.

## **II. Kushtet e veçanta për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime**

1. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
  - 1.1. Të ketë gradën shkencore Doktor i shkencave nga lëmia përkatëse (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të). Kandidatët të cilët krahas thirrjes Doktor i shkencave kanë edhe thirrje akademike të ligjëruesit ose profesorit, të fituar në një nga universitetet publike, kanë përparësi në përzgjedhje.
  - 1.2. Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse) në përputhje me rregullën në fuqi për emërimin e personelit akademik.
2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të kenë të përfunduar studimet master ose ekuivalent me të në lëmin përkatëse.
  - 2.2. Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.
  - 2.3. Përparësi në angazhim kanë kandidatët me gradën doktor i shkencave, të cilët plotësojnë kushtet e sipas pikës 2.1 dhe 2.2.
3. Komisionet vlerësuese dhe këshillat e njëjshme akademike janë të obliguara që propozimet e tyre për pozitat e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të jenë në përputhje të plotë më [kodet e zonave të lëndëve të ERASMUS-it](#), në të kundërtën përgjegjësia bie mbi ta dhe propozimet nuk mund të pranohen nga Senati.

### III. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata mund të mbajnë deri në 6 ore në javë.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në 10 ore në javë.
3. Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm më gradën adekuate, në përputhje me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata në nivelin bachelor mund të angazhohen edhe kandidatët më gradën e Magjistrisë (Mr. Sc.) ose Masterit (MA), nën mbikëqyrjen e profesorit më gradën Dr. Sc.
4. Pagesa për kategorinë nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet si për bashkëpunëtorin për ushtrime.

### III. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- I. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
  - a) kërkesën më biografi;
  - b) certifikatën e lindjes (jo me te vjetër së 6 muaj);
  - c) kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatet të cilët kanë diplomuar jashtë vendi, duhet të sjellin vendimin për nostrifikim-barasvlerën e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë, doktoratë);
  - d) kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime, lektorit duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe atyre master të noterizuara;
  - e) dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë;
  - f) dëshmitë për angazhimet paraprake në UHZ ose në ndonjë Institucion të akredituar të arsimit të lartë;
  - g) dëshmia për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për konkurruesit.
  - h) Dëshmi të organeve kompetente që nuk është nën hetime (jo me te vjetër së 6 muaj);
  - i) Aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen fare.
  - j) Kandidatët që kanë kontratë të rregullt të punës në Universitetet Publike në Kosovë dhe jashtë Kosovës më të cilat UHZ-ja, ka marrëveshje të bashkëpunimi për shkëmbim të personelit akademik dhe e cila është në fuqi ose kandidatët që kanë pasur angazhime edhe në të kaluarën dhe kanë dosjen në UHZ duhet të sjellin dokumentet si në vijim: **a)** Kërkesën me biografi (CV) duke specifikuar pozitën për të cilën aplikon dhe **b)** kopjen e vendimit për zgjedhjen e fundit që dëshmon thirrjen akademike pranë një institucioni publik të arsimit të lartë.

#### **IV. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi**

1. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë dhe kohëzgjatjes së angazhimit.
2. Kompensimi do të bëhet sipas raportit të orëve të realizuara, të nxjerra nga sistemi elektronik gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia akademike përkatëse, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas akteve të brendshme të UHZ - së.
3. Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit UHZ - së, Ligjin NR. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212, përkatësisht dispozitave të nenit 8, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, paragrafit 4, 7 dhe 8, nenit 11 dhe nenit 14 të këtij ligji.

#### **V. E drejta e ankesës**

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë komisionit për ankese të njësisë akademike përkatëse, brenda 4 ditëve, nga dita e publikimit të vendimit të këshillit të fakultetit në web faqen e UHZ-së.
3. Komisioni i ankesave më së largu 3 dite, pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës të njëjtën ditë e dorëzon në këshill të fakultetit. Këshilli i fakultetit në afat prej 3 ditëve, nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendosë për miratim ose refuzim të tij.
4. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante dhe arsyeshmërinë e kontestimit të vendimit.
5. Shqyrtimi i ankesave dhe marrja e vendimit përkatës në këshillin e njësisë akademike është vendim përfundimtar në nivel të Universitetit.

**Vërejtje:** Angazhimi në pozitat e lartshënuara do të bëhet varësisht nga plotësimi i vendeve të lartcekura më staf të rregullt akademik dhe numrin e grupeve të studentëve. Kandidatët e përzgjedhur në raste të tilla ose në çfarëdo shtate tjetër që nuk mund të parashihet ose varët nga Universiteti, do të informohen më kohë lidhur me angazhimin apo mos angazhimin, para fillimit të çdo semestri.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen të skanuara në adresën elektronike [apliko.online@unhz.eu](mailto:apliko.online@unhz.eu), duke specifikuar saktë pozitën në të cilën aplikohet.

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë ditë kalendarike) në <http://www.unhz.eu>, respektivisht deri me datën 23.10.2023.

